




# LIGJSHMËRIA E AVANCIMEVE DHE PËRFITIMEVE NË ZYRËN E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT



Autor: Lavdim Bajraktari

Redaktor: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

*Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

Shkurt, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

# PËRMBAJTJA

---

5

Përmbledhje  
ekzekutive

6

Metodologjia

7

Mandati ligjor dhe  
organizimi i ZKPSH-së

8

Numri i prokurorëve  
në ZKPSH

9

Pagat e prokurorëve në  
ZKPSH

10

Ngarkesa me lëndë dhe  
efikasiteti i ZKPSH-së

12

Avancimi i prokurorëve  
në ZKPSH

19

Integriteti i kontestuar i  
Zyrës së Kryeprokurorit të  
Shtetit

27

Rekomandime

<b>IKD</b>	<b>INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI</b>
<b>KPK</b>	<b>KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS</b>
<b>OSBE</b>	<b>ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EUROPE</b>
<b>PSRK</b>	<b>PROKURORIA SPECIALE REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>
<b>PTH</b>	<b>PROKURORI THEMELORE</b>
<b>RREGULLORJA</b>	<b>RREGULLORE NR.03/2016 PËR TRANSFERIMIN DHE AVANCIMIN E PROKURORËVE TË SHTETIT</b>
<b>U.D.</b>	<b>USHTRUES DETYRE</b>
<b>UNDP</b>	<b>PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM</b>
<b>ZKPSH</b>	<b>ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT</b>

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), si institucioni më i lartë në hierarkinë e sistemit prokurorial të Kosovës, llogaritet të ketë brenda vetes prokurorët më të përgatitur dhe më profesional në vend, apo “ajkën e prokurorëve”. Si e tillë, sytë e prokurorëve të tjerë por edhe qytetarëve do duheshin tek drejtoheshin tek kjo Zyrë kur vije puna tek zbatim i ligjit.

Por, dallimi mes asaj se si do “duhet” të ishte dhe si është në realitet, fatkeqësisht është shumë i madh. Me një integritet jashtëzakonisht të cenuar, e që ka ardhur si pasojë e shumë veprimeve kundërligjore që janë marrë nga kjo Zyrë, përkatësisht nga Kryeprokurori i Shtetit, ka bërë që besimi i qytetarëve në sistemin prokurorial në veçanti dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi të jetë në nivele minimale. Pas shumë veprimeve që e kanë cenuar integritetin e kësaj Zyre, duke përfshirë aferat e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, si “Dosja e manipuluar e provimit të jurisprudencës”, përfshirjes në aferën “Pronto” dhe atë të “Veteranëve të rrejshëm”, së fundmi, nga ZKPSH ka dalë edhe një vendim për transferimin e prokurorit Bahri Hyseni nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Ferizaj në ZKPSH.

Ky transferim, që në praktikë paraqet avancim pa asnjë konkurs, është bërë me arsyetimin se një nevojë e tillë është paraqitur për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Por, bazuar në numrin e prokurorëve që i ka ZKPSH dhe në ngarkesën me lëndë që ka kjo Zyrë, atëherë nuk ka asnjë institucion prokurorial në Kosovë që qëndron më mirë në këtë aspekt dhe rrjedhimisht, me më sa paku nevojë për prokurorë të rinj.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është institucioni prokurorial që është më së paku i ngarkuar me lëndë. Përkitazi me këtë, prokurorët që janë në ZKPSH brenda vitit arrijnë t’i zgjidhin thuajse të gjitha lëndët që i ka në punë kjo Zyrë, duke bërë që për dallim nga prokuroritë tjera, nga ZKPSH barten pak ose thuajse aspak lëndë për vitin pasues.

Me paga mujore që shkojnë nga 2,655 euro për prokurorët e ZKPSH-së e deri në 2,950 euro për Kryeprokurorin e Shtetit, këtë funksionarë publikë janë më të paguarit në Kosovë. Përkundër nevojave që janë cekur si arsye për transferim të prokurorëve të rinj në këtë Zyrë, një numër i madh i prokurorëve të ZKPSH-së mbajnë edhe nga dy apo më shumë pozita tjera në institucione publike apo private, apo deri edhe në gjashtë (6) pozita siç kishte qenë rasti i Kryeprokurorit të Shtetit.

## 2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik në lidhje me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Ky raport i IKD-së është bazuar në të dhënat e siguruar nga dokumente të ndryshme zyrtare, legjislacionin primar dhe sekondar, raporte zyrtare të Prokurorit të Shtetit si dhe të dhënat të siguruar përmes kërkesave për informata dhe qasje në dokumente zyrtare nga institucionet relevante.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe politikat e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.

Para së gjithash, ky raport është derivat i monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit prokurorial dhe gjyqësor duke përfshirë këtu edhe punën e ZKP-së, Këshillit Prokurorial dhe atij Gjyqësor të Kosovës.

Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar deklaratimet e pasurisë të të gjithë prokurorëve në ZKPSH. Në këtë rast, një pjesë e madhe e prokurorëve kanë deklaruar pagën e tyre bazë pa e ndarë të njëjtën me pagesat tjera shtesë,

kompensimet e mëditjet që kanë realizuar. Kësisoj, në këto raste, IKD ka llogaritur pagën bruto të prokurorëve të përcaktuar me ligj dhe pas nxjerrjes së totalit të pagës bazë, pjesën tjetër të të ardhurave të deklaruara i ka llogaritur si të hyra shtesë jashtë pagës bazë.

Të gjitha gjetjet e monitorimit sistematik grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën analistët juridikë të IKD-së zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e siguruar.

Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që kanë në interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të analizës së kornizës ligjore, krahasimit të rasteve dhe vendimeve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimit të thuktë të çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Ky raport përfshinë të dhënat për një periudhë nga viti 2017 deri në shkurt 2021.

### 3. Mandati ligjor dhe organizimi i ZKPSH-së

Në strukturën organizative dhe juridiksionit të Prokurorit të Shtetit, Kryeprokurori i Shtetit mban pozitën më të lartë në sistemin prokurorial të Kosovës.

Kompetencat ligjore të Kryeprokurorit të Shtetit janë përcaktuar fillimisht me Ligjin për Prokurorin e Shtetit<sup>1</sup> të miratuar në vitin 2010 dhe pastaj me Ligjin për Prokurorin e Shtetit të vitit 2015.<sup>2</sup>

Sipas këtij të fundit, Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit që ka përgjegjësinë edhe për menaxhimin dhe përfaqësimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit, me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe me kompetencë ekskluzive për lëndë në shkallë të tretë në Gjykatën Supreme dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Kompetencë tjetër është edhe nxjerrja me shkrim e rregullave, udhëzimeve dhe vendimeve të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) udhëhiqet nga Kryeprokurori i Shtetit, i cili emërohet nga Presidenti i

Republikës së Kosovës, pas propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me mandat shtatë (7) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje. Kryeprokuror aktual i Shtetit, nga prilli i vitit 2015 është Aleksandër Lumezi.

Në kuadër të ZKPSH-së është edhe Zëvendëskryeprokurori i Shtetit i cili caktohet nga Kryeprokurori i Shtetit nga radhët e prokurorëve në ZKPSH, dhe i/e cili e zëvendëson Kryeprokurorin e Shtetit në rast të mungesës së këtij të fundit. Këtë pozitë, aktualisht e ushtron znj. Sevdije Morina, ish anëtare e KPK-së nga radhët e PSRK-së dhe ish U.D. e Kryeprokurores së PSRK-së.

<sup>1</sup> Ligjin nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.

<sup>2</sup> Ligjin Nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/1-225 për Prokurorin e Shtetit të vitit 2015.

## 4. Numri i prokurorëve në ZKPSH

Bazuar në të dhënat zyrtare të paraqitura në raportet e punës së Prokurorit të Shtetit, ZKPSH, në vitin 2017 kishte pasur gjithsej gjashtë (6) prokurorë duke përfshirë këtu edhe kryeprokurorin.<sup>3</sup> Kurse, gjatë viteve

2018<sup>4</sup>, 2019<sup>5</sup> dhe 2020, ZKPSH kishte pasur nga tetë (8) prokurorë duke përfshirë këtu edhe kryeprokurorin. Në shkurt 2021, në këtë prokurori është transferuar edhe një prokuror tjetër ashtu që së bashku me kryeprokurorin, ZKPSH tashmë ka nëntë (9) prokurorë.<sup>67</sup>



Grafika 1: Numri i prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, sipas viteve.

<sup>3</sup> Prokurori i Shtetit. *Raporti i Punës 2017*. Mars 2018.

<sup>4</sup> Prokurori i Shtetit. *Raporti i Punës 2018*. Shkurt 2019.

<sup>5</sup> Prokurori i Shtetit. *Raporti i Punës 2019*. Mars 2020. (Shih linkun: [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument\\_e%20Publikime/PSH/Raporte/Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20p%C3%ABr%20vitin%202019.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument_e%20Publikime/PSH/Raporte/Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20p%C3%ABr%20vitin%202019.pdf)) Qasur për herën e fundit më 10 shkurt 2021.


<sup>6</sup> Prokurori i Shtetit. *Raporti i Punës nëntëmuajori 2020*. Tetor 2020. (Shih linkun: [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument\\_e%20Publikime/PSH/Raporte/1.%20Raporti%20n%C3%ABnt%C3%ABmuajori%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20-%20Shqip.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument_e%20Publikime/PSH/Raporte/1.%20Raporti%20n%C3%ABnt%C3%ABmuajori%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20-%20Shqip.pdf)) Qasur për herën e fundit më 10 shkurt 2021.

<sup>7</sup> **Shënim:** Në shkurt të vitit 2021, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit është transferuar prokurori Bahri Hyseni.

## 5. Pagat e prokurorëve në ZKPSH

Për punën e tyre në këtë Zyrë, kryeprokurori dhe prokurorët e tjerë që punojnë në ZKPSH janë ndër zyrtarët më të paguar në Kosovë. Konkretisht, Kryeprokurori i Shtetit merr pagë mujore prej buxhetit të shtetit, 2,950 euro kurse prokurorët me mandat të përhershëm që punojnë në këtë zyrë marrin pagë mujore prej 2,655 euro.<sup>8</sup> Buxheti i Republikës së Kosovës

brenda vitit paguan afërsisht 300.000 euro vetëm për pagat e këtyre prokurorëve, pa përfshirë privilegjet dhe përfitimet e tjera si makina, mëditje, kompensime dhe shpenzimet të tjera që dalin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. E gjithë kjo, pa përfshirë shpenzimet për stafin mbështetës të kësaj zyre.



Grafika 2: Pagat mujore të Kryeprokurorit të Shtetit dhe të prokurorëve në ZKPSH.

<sup>8</sup> **Shënim:** Lartësia e këtyre pagave bazohet në vendimin nr.4/20, të Qeverisë Haradinaj. (Shih vendimin nr.4/20 të Qeverisë Haradinaj, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_20.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_20.pdf)) Qasur për herën e fundit 10.02.2021. Ky vendim i Qeverisë Haradinaj ishte shfuqizuar pjesërisht nga vendimi nr.01/02 i Qeverisë Kurti, por, lartësia pagave

të prokurorëve dhe gjyqtarëve kishte mbetur sipas vendimit të Qeverisë Haradinaj. (Shih vendimin nr.01/02 (Shih vendimin: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/02/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-2-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>) Qasur për herën e fundit më 10 shkurt 2021).

## 6. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i ZKPSH-së

ZKPSH ka dy kompetenca kryesore gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, e që janë veprimi dhe përfaqësimi në Gjykatën Supreme dhe nxjerrja e rregullave, udhëzimeve dhe vendimeve të përgjithshme.

### a) Veprimi dhe përfaqësimi në Gjykatën Supreme

Përderisa prokurorët në prokurori themelore dhe PSRK për çdo rast të tyre duhet të ndër marrin një varg veprimesh hetimore dhe procedurale në secilën lëndë që trajtojnë, prokurorët në ZKPSH punën e tyre duhet ta bazojnë kryesisht në ekspertizën dhe përvojën e tyre të fituar përgjatë viteve. Sidoqoftë, numër i madh i prokurorëve në këtë zyre, përvojën e tyre të vetme e kanë pasur në prokuroritë e niveleve me të ulëta, duke mos pasur asnjë ditë përvojë pune në Prokurorinë e Apelit. Shumica e prokurorëve në ZKPSH nuk e kanë as edhe një ditë përvojë pune në departamentet për krime të rënda, qoftë në prokuroritë themelore, Prokurorinë e Apelit apo edhe në PSRK.

Në këtë drejtim nga viti 2015, ZKPSH është kthyer në një zyre të "pensionistëve" por që këta "pensionistë" janë të ri në moshë dhe pa përvojë. Për më tepër, "pensionet"

në këtë rast paguhen nga qytetarët e Kosovës me së paku mbi 31.000 euro në vit për secilin prej tyre, pa përfshirë privilegjet dhe beneficionet e tjera.


Sa i përket ngarkesës me lëndë, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2020, numri total i lëndëve që ishin pranuar nga të gjitha prokuroritë në Kosovë kishte qenë 29,768, kurse si total në punë kishin qenë 116,772 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, ZKPSH kishte pasur në punë gjithsej 782 lëndë apo kthyer në përqindje, 0.66% të lëndëve nga totali i lëndëve që kishin pasur në punë të gjitha prokuroritë në Kosovë.

Përballë përqindjes së ngarkesës me lëndë në ZKPSH nga numri i total i prokurorëve në sistemin prokurorial, ZKPSH gjatë vitit 2020 është përfaqësuar me 4.18% të prokurorëve.<sup>9</sup>

Tutje, nga ky numër i lëndëve, ZKPSH kishte arritur t'i zgjidh gjithsej 758 lëndë gjatë kësaj periudhe. Sipas indikatorëve të Komisionit Evropian për efikasitetin në drejtësi, puna gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2020 e ZKPSH-së përkthehet në efikasitet prej 99%.<sup>10</sup> Siç shihet në tabelën në vijim, ZKPSH që nga viti 2017 asnjëherë nuk ka pasur problem me ngarkesën me lëndë. Porse, pavarësisht kësaj, ZKPSH vit pas viti ka ngritur numrin e prokurorëve në këtë zyrë.

<sup>9</sup> **Shënim:** Sipas raportit të punës së Prokurorit të Shtetit, në tetor 2020 numri total i prokurorëve kishte qenë 191.

<sup>10</sup> Lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranuar.



**Grafika 3: Lëndët e pranuar vs. Lëndët e përfunduara nga ZKPSH gjatë viteve 2017-2020.**

Lidhur me numrin e prokurorëve në ZKPSH, kjo e fundit në një përgjigje për IKD ka theksuar se ky numër përcaktohet sipas nevojave dhe vlerësimeve që bëhen nga institucionit, ndërsa në përgjigje potencohen edhe detyrat që këta prokurorë janë të obliguar t'i kryejnë si dhe lëndët e kryera gjatë vitit 2020.<sup>11</sup>

Por, siç shihet edhe nga grafika nr.1 dhe grafika nr.3 e këtij raporti, përderisa ngarkesa me lëndë e kësaj prokurorie ka mbetur pak a shumë e njëjtë gjatë viteve, i njëjtë thuhet se ka mbetur edhe efikasiteti i kryerjes së lëndëve ndërsa rritje ka pësuar vetëm numri i prokurorëve. Pra, rrjedhimisht, shtimi i numrit të prokurorëve në këtë Zyrë, nuk ka bërë ndonjë diferencë, pasi që problemi me këtë ngarkesë, nuk ka

ekzistuar asnjëherë në këtë Zyrë. Për më tepër, kjo rritje e numrit të prokurorëve nuk është përkthyer as në publikime të buletineve, qëndrimeve juridike apo rritjen e numrit të rregullave, udhëtimeve apo vendimeve me shkrim nga ZKPSH, siç përcaktohet me Ligjin për Prokurorin e Shtetit.

**b) Nxjerrja me shkrim e rregullave, udhëzimeve dhe vendimeve të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët**

Sipas Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Kryeprokurori i Shtetit “nxjerr me shkrim rregulla, udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë,

<sup>11</sup> Përgjigje me shkrim nga ZKPSH për IKD. 12 shkurt 2021.

ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit”.<sup>12</sup>

ZKPSH në bazë të kësaj kompetence do të duhej që përmes rregullave dhe udhëzimeve të ndërtojë praktika unike për prokurorët e niveleve më të ulëta lidhur me ndjekjen penale për fusha të caktuara.

Që nga viti 2015 kur ka hyrë në fuqi Ligji për Prokurorin e Shtetit, ZKPSH pothuajse nuk e ka praktikuar asnjëherë këtë obligim ligjor, përkundrazi, edhe në ato raste të rralla kur ka lëshuar udhëzime të detyrueshme, të njëjtat kanë qenë në kundërshtim me ligjin.

Ndër udhëzimet e detyrueshme të miratuara nga Kryeprokurori i Shtetit që e kanë kontestuar aspektin ligjor janë:

- 1) Udhëzim për informimin e Kryeprokurorit të shtetit për rastet e korrupsionit ndaj zyrtarëve të lartë shtetëror në afat prej 5 ditësh;<sup>13</sup>
- 2) Udhëzim me të cilin prokurorët e shtetit obligohen që brenda afatit prej tre (3) muajsh pas

<sup>12</sup> Ligji nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit. Neni 11.1.5.

<sup>13</sup> Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. *Udhëzim i Detyrueshëm*. A.nr.577/2016. 30.12.2015. (Shih linkun: [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument\\_e%20Publikime/PSH/AkteNenLigjore/Udhezime/Nr.1431.2015-Udhezim\\_te\\_Detyrueshem\\_-\\_ZKPSH.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument_e%20Publikime/PSH/AkteNenLigjore/Udhezime/Nr.1431.2015-Udhezim_te_Detyrueshem_-_ZKPSH.pdf)) Qasur për herën e fundit më 10.02.2021.

<sup>14</sup> Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Udhëzim. 02.12.2015 (Shih linkun: [https://prokuroria-](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument_e%20Publikime/PSH/AkteNenLigjore/Udhezime/Nr.1288.2015-Udhezim-PSH.pdf)

pranimi të Kallëzimit Penal, nëse nuk hudhet, të nxirret aktvendim për fillim të hetimeve.<sup>14</sup>

Miratimi i këtyre dy (2) udhëzimeve përveç që është bërë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale kanë karakter kontrollues dhe centralizues në raport me pavarësinë individuale të prokurorëve.

Udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit ishin kontestuar si të paligjshme edhe nga vet Gjykata Supreme si autoriteti më i lartë i interpretimit të ligjeve.<sup>15</sup>

## 7. Avancimi i prokurorëve në ZKPSH

Rekrutimi, transferimi dhe avancimi i prokurorëve është i rregulluar me Kushtetutë, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe rregulloret e miratuara nga KPK.<sup>16</sup> Kjo rregullore përcakton se avancimi dhe transferimi i prokurorëve do të bëhet sipas një procedurë objektive e të paanshme dhe duke u bazuar në kritere siç janë, **aftësia profesionale, merita dhe përvoja.**

[rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument\\_e%20Publikime/PSH/AkteNenLigjore/Udhezime/Nr.1288.2015-Udhezim-PSH.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokument_e%20Publikime/PSH/AkteNenLigjore/Udhezime/Nr.1288.2015-Udhezim-PSH.pdf))

<sup>15</sup> Gjykata Supreme e Kosovës. Mendim Juridik. 29.09.2016 (Shih linkun: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/2.mendim\\_juridik-prokurori.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/2.mendim_juridik-prokurori.pdf)) Qasur për herën e fundit më 10.02.2021.

<sup>16</sup> Rregullore nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.

Që nga viti 2015, Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi në kundërshtim me Kushtetutë dhe me ligj ka ndërtuar praktikat e avancimit të prokurorëve të afërt me të, ku përfshihen prokurorë si Kujtim Munishi, Bahri Hyseni dhe Agron Qalaj.

Lidhur me çështjen e avancimeve, ZKPSH në një përgjigje për IKD ka theksuar se asnjë prokuror nuk është avancuar por vetëm janë caktuar apo transferuar në ZKPSH me kohë të përkohshme, për të ndihmuar ZKPSH-në sipas nevojave të tij. Sipas ZKPSH-së, caktimi apo transferimi i përkohshëm është bërë bazuar në nenin 28.6 të Ligjit për KPK-në, ku shprehimisht thuhet *“Kryeprokurori i Shtetit mund të caktoj një prokuror nga një prokurori në një prokurori tjetër në pajtim me legjislacionin në fuqi”*.<sup>17</sup>

Por, është pikërisht legjislacioni në fuqi i cili përcaktohet me Ligjin për KPK-në, që e bënë të qartë dallimin mes transferimit dhe avancimit.

Ky dallim të cilin e bënë rregullorja për transferim dhe avancim të prokurorëve, konsiston në atë se transferimi bëhet 1) Nga një departament i prokurorisë në departamentin e prokurorisë tjetër të nivelit të njëjtë, 2) Nga Departamenti për të mitur në Departamentin për Krime të Rënda ose anasjelltas dhe 3) Nga një departament i specializuar në Departamentin e Përgjithshëm. Sipas po kësaj rregullore, dallimi i vetëm që

bëhet në rastin e transferimit të përkohshëm me atë të përhershëm është se ky transferim bëhet për një periudhë të caktuar kohore. Ndërsa, në po këtë rregullore përcaktohet edhe avancimi i prokurorëve, ku ndër të tjera thuhet se me avancim kemi të bëjmë në rastet e kalimit të një prokurori nga një departament i prokurorisë themelore, Prokurorisë së Apelit apo nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Për këtë arsye, sipas ligjit dhe rregullave të miratuara nga KPK, kalimi i një prokurori nga një prokurori e nivelit më të ulët në një prokurori të nivelit më të lartë konsiderohet avancim, dhe jo transferim.

Në rastet konkrete të cilat janë paraqitur në këtë raport, prokurorët kishin kaluar nga prokuroritë e shkallës së parë në ZKPSH, pra në nivelin e tretë dhe më të lartë të sistemit prokurorial. Krejt kjo ishte bërë me vendime të kryeprokurorit, pa iu nënshtruar prokurorët përkatës konkurseve për avancim.

### **7.1. Avancimi i kundërligjshëm i Kujtim Munishit**

Me një vendim të kundërligjshëm të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, të marrë më 28 prill 2015, prokurorit të atëhershëm në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Kujtim Munishi i ish-in deleguar kompetencat në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Kjo ngritje

<sup>17</sup> Përgjigje me shkrim nga ZKPSH për IKD. 12 shkurt 2021.

“meteorike” e prokurorit Munishi kishte ardhur vetëm rreth dy vite e gjysmë pasi i njëjti ishte zgjedhur prokuror.

Prokurori Munishi kishte qenë ende me mandat fillestar kur ishte caktuar në ZKPSH nga kryeprokurori Lumezi.

Vendim i kundërligjshëm i kryeprokurorit Lumezi, bazohej në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit të vitit 2010, i cili kishte qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit, e që është data 28 prill 2015. Neni 20, pika 1.4., e atij ligji qartëson se për të ushtruar funksionin e prokurorit pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati duhet të ketë së paku gjashtë (6) vjet përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku katër (4) vjet përvojë si prokuror.<sup>18</sup>

Vetëm pak vite më vonë, përkatësisht gjatë vitit 2017, prokurori Munishi kishte qenë ai i cili pas vetëm 21 ditë hetime, e kishte mbyllur rastin e dyshuar për falsifikim e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi. Hetimet ishin kryer dhe mbyllur në këtë rast, nga Munishi si prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë edhe pse sipas legjislacionit në fuqi, rastet e profilit të lartë, sikurse që ka qenë rasti i kryeprokurorit Lumezi, duhet të trajtohen nga Prokuroria

Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), që në rastin konkret nuk ka ndodhur.

## 7.2. Avancimi i kundërligjshëm i Agron Qalajt

Kryeprokurori i Shtetit, më 2 shkurt 2017 nga Prokuroria Themelore në Ferizaj e kishte transferuar në ZKPSH, prokurorin Agron Qalaj. Këtë transferim, kryeprokurori e kishte bërë për një periudhë prej një muaji. Pas kërkesës së kryeprokurorit, KPK më 9 mars 2017 kishte marr vendim që prokurorit Qalaj t'i zgjatet transferimi në KPK për një periudhë prej gjashtë (6) muajve.<sup>19</sup> Atë kohë, ky transferim ishte arsyetuar me faktin se një prokuror i ZKPSH-së kishte shkuar në pushim mjekësor. Por, edhe pse formalisht ishte quajtur transferim, në fakt, në këtë rast kishim pasur të bëjmë me avancim të prokurorit Qalaj me një vendim të kryeprokurorit, pa kaluar përmes procedurave dhe kriterëve të përcaktuara me ligj dhe rregullore.

## 7.3. Avancimi i kundërligjshëm i Bahri Hysenit

Prokurorit Bahri Hyseni i kishte përfunduar mandati si kryesues në KPK në fund të dhjetorit të vitit 2020. Si rrjedhojë e kësaj, nga janari 2021, Hyseni ishte kthyer si prokuror i Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Por, nuk kishte shkuar shumë dhe me

<sup>18</sup> Shih raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi “*Dosja e manipuluar e kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi*”. Nëntor 2017. (Shih linkun: <http://klicks.org/wp-content/uploads/2017/11/02.->

[Analiza-ligjore-e-rastit-Lumezi-21.11.2017-1.pdf](#)) Qasur për herën e fundit më 9 shkurt 2021.

<sup>19</sup> Vendimi i KPK-së, 104/2017. 9 mars 2017.

vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, Hyseni është transferuar për të punuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Një vendim i tillë, ishte marrë në shpërfillje të plotë me dispozitat ligjore si dhe nevojat e ZKPSH-së. Ligji për KPK-në ka përcaktuar mënyrën dhe rastet kur bëhet transferimi i prokurorëve.<sup>20</sup>

Gjithashtu, edhe Rregullorja e lartcekur ka përcaktuar se shpallja e pozitive të lira për transferim dhe avancim të prokurorëve bëhet së paku dy herë në vit dhe e njëjta shpallje publikohet edhe në faqen zyrtare të KPK-së dhe të Prokurorit të Shtetit. Por, këto procedura nuk janë përfillur me rastin e z. Hysenit. Në këtë rast, z. Hyseni ka kaluar në ZKPSH me një vendim të Kryeprokurorit të Shtetit.

Ligji për KPK ka lënë mundësinë që në **raste të jashtëzakonshme**, Kryeprokurori i Shtetit mundet të caktoj një prokuror nga një prokurori në një prokurori tjetër, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.<sup>21</sup> Po ashtu, edhe Rregullorja i lë mundësinë Kryeprokurorit të Shtetit që në raste të jashtëzakonshme të transferoj sipas detyrës zyrtare një prokuror nga një prokurori në një tjetër për një periudhë prej jo më gjatë se 30 ditë, përveç nëse KPK miraton një periudhë më të gjatë.<sup>22</sup>

Siç u cek edhe më lartë, ZKPSH është institucioni më së paku i ngarkuar me lëndë në krejt sistemin prokurorial në Kosovë. Me numrin e prokurorëve në ZKPSH, lëndët që ka pasur në punë kjo Zyrë janë zgjidhur brenda vitit pa pasur vonesa siç mund të jetë rasti tek prokuroritë e shkallës së parë.

Për këtë arsye, në rastin e z. Hysenit nuk ka pasur “rrethana e jashtëzakonshme” që ka determinuar që ky i fundit të kalojë në ZKPSH me një urgjencë të tillë pa kaluar përmes një konkursi.

Po ashtu, as meritat apo profesionalizmi në këtë rast nuk mund të merren si rrethana të tilla që do të arsyetonin një transferim të jashtëzakonshëm. Për më tepër, z. Hyseni vjen nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, si niveli më i ulët në sistemin prokurorial. Si i tillë, i njëjti ka parakaluar kolegët e tij nga departamentet për krime të rënda, Prokuroria Speciale dhe Prokuroria e Apelit, për të ofruar kështu “ekspertizën” e tij në ZKPSH.

Qëllimi i Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, para se gjithash ka qenë përcaktimi i qartë i kriterëve për avancimin dhe transferimin e prokurorëve bazuar në meritat e tyre. Rrjedhimisht, me këtë ishte menduar të

<sup>20</sup> Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Neni 28.

<sup>21</sup> Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Neni 28.6.

<sup>22</sup> Rregullore nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit. Neni 7.2

ndalohej praktika e transferimit dhe avancimeve të prokurorëve pa konkurse, duke shmangur avancimet apo transferimet pa kritere dhe të pabazuara në meritë.

Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit, për sa i përket rastit konkret të prokurorit Bahri Hyseni, bie në kundërshtim me aktet që janë nxjerrë nga KPK, institucion të cilin z. Hyseni e ka kryesuar deri në fund të vitit 2020.

Në këtë rast, Rregullorja përcakton se transferimi bëhet brenda një niveli të njëjtë të prokurorive apo departamenteve me kushte të njëjta, apo edhe transferim më të ulët me kërkesë të vet prokurorit.

Ndërsa, kalimi i një prokurori nga një prokurori e nivelit më të ulët, siç është rasti konkret i Prokurorisë Themelore në Ferizaj në një nivel më të lartë, siç është ZKPSH, nënkupton avancim apo ngritje në detyrë.

Sa për ilustrim, paga e një prokurori të departamentit të përgjithshëm të prokurorive themelore është 1,672 euro kurse paga e prokurorëve në kuadër të ZKPSH-së është 2,655 euro. Pra, me këtë transferim, prokurori Hyseni do të merr një pagë mujore që është gati 1,000 euro më e madhe se sa paga që i njëjti e realizonte si prokuror në PTh Ferizaj.

Gjithashtu, në rastin e z. Hyseni ka edhe konflikt të interesit. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, i miratuar në vitin 2018, ka përcaktuar

edhe kuptimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Lidhur me kuptimin e konfliktit të interesit, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik ka përcaktuar se:

*“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose **duket se ndikon** në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.*

Lidhur me konfliktin në dukje të interesit, Udhëzuesi i Projektit kundër Krimin Ekonomik në Kosovës përcakton se “Dukja e konfliktit të interesit duhet të mbështetet në fakte specifike, që paraqesin arsye të bazuara se përse mund të ndodhë konflikti i interesit. Nuk ka konflikt në dukje të interesit kur arsyet janë të paqarta dhe dyshimet janë të rrënjosura në mosbesimin e përgjithshëm të institucionet publike”.

Në rastin konkret, fillimisht duhet përmendur faktin se deri në fund të dhjetorit 2020, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe ish-kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, kanë qenë kolegë në KPK. Po ashtu, bazuar në ligjet në fuqi, KPK është organ i cili mban përgjegjësi të gjitha prokuroritë, përfshirë këtu edhe ZKPSH-në. Në këtë drejtim, për dështimet e Kryeprokurorit të Shtetit, përgjegjësia për mos mbajtje përgjegjësi i atribuohet edhe KPK-së, i cili institucion deri para pak kohe është kryesuar nga ana e z. Bahri Hyseni.

Në këtë drejtim, avancimi pa konkurs në ZKPSH, nga niveli më i ulët brenda sistemit prokurorial, pa asnjë nevojë të jashtëzakonshme, në kundërshtim me rregullat në fuqi, kolegialiteti i z. Lumezi me z. Hyseni për pesë (5) vite në KPK dhe fakti se institucioni që z. Hyseni ka udhëhequr ka pasur për mandat mbajtjen llogaridhënës të Kryeprokurorit të Shtetit janë fakte specifike dhe që ndërtojnë argumentin se në rastin konkret kemi të bëjmë me konflikt të hapur në dukje të interesit.

Tutje, në mbledhjen e KPK-së të mbajtur më 8 shkurt 2021, prokurori Hyseni është zgjedhur edhe anëtar i Komisionit për Çështje Normative të KPK-së nga ZKPSH. Paraprakisht, z. Hyseni kishte qenë anëtar nga viti 2013 dhe më pas edhe kryesues i këtij komisioni nga viti 2016 deri në vitin 2018.

Lidhur me këtë ka reaguar edhe Ambasada Amerikane, përkatësisht Këshilltarja Ligjore në këtë ambasadë, Znj. Lana Owens. E njëjta gjatë mbledhjes në fjalë kishte kritikuar vendimet e KPK-së për transferime të prokurorëve pa kaluar në procese të rregullta të avancimit të prokurorëve në sistemin prokurorial.<sup>23</sup>

Gjithashtu, Ligji për KPK-në përcakton se “Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të

<sup>23</sup> “Ambasada Amerikane kritikon vendimmarrjen e KPK-së dhe kërkon nga KPK-ja që të respektojë ligjet dhe rregullat e miratuara nga vet ky organ”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2021. (Shih linkun: [https://betimiperdrejtesi.com/ambasada-](https://betimiperdrejtesi.com/ambasada-amerikane-kritikon-vendimmarrjen-e-kpk-se-dhe-kerkon-nga-kpk-ja-qe-te-respektoje-ligjet-dhe-rregullat-e-miratuara-nga-vet-ky-organ/)

*ngritët në detyrë në sistemin prokurorial”.*<sup>24</sup>

Në këtë rast, avancimi në ZKPSH i z. Hysenit, pak ditë pas mbarimit të mandatit të tij në KPK, paçka se formalisht nuk bie ndesh me dispozitën në fjalë, pa dyshim se cenon integritetin e sistemit prokurorial dhe besimit të publikut.

#### **7.4 Avancimi i Shqipdon Fazliut**

Prokuror tjetër që është avancuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore është prokurori Shqipdon Fazliu.

Fazliu në vitin 2010 kishte filluar punën si Prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe më pas ishte avancuar në Departamentin për Krime të Rënda në këtë prokurori.

Në vitin 2018, përmes konkursit, Fazliu kishte kaluar nga prokuroria themelore në zyrën më të lartë brenda sistemit prokurorial të Kosovës.

#### **7.5. Avancimi i prokurorëve të tjerë në ZKPSH**

##### **a) Sevdije Morina**

Shembull të mirë për zbatim të ligjit nuk ka dhënë në të kaluarën as vartësja e kryeprokurorit Lumezi, Zëvendëskryeprokurorja e ZKPSH-së, Sevdije Morina. Kjo e fundit, gjatë

[amerikane-kritikon-vendimmarrjen-e-kpk-se-dhe-kerkon-nga-kpk-ja-qe-te-respektoje-ligjet-dhe-rregullat-e-miratuara-nga-vet-ky-organ/](#)) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

<sup>24</sup> Ligjit Nr.06/L-056 për KPK-në. Neni 9.5.

kohës sa kishte qenë anëtare e KPK-së nga radhët e PSRK-së, edhe përkundër faktit se ligji ia përcaktonte se mandati i saj në KPK është pesë (5) vjeçar pa mundësi vazhdimi, e njëjta kishte qëndruar si anëtare e KPK-së për afërsisht pesë vite e nëntë muaj. Duke qëndruar në KPK me mandat të kontestuar, znj. Morina kishte marr pjesë në diskutim dhe kishte votuar lidhur me zgjatjen e mandatit të vet. Ky votim për zgjatjen e mandatit për vete, i cili krijonte fuqi në mundësinë e vendimmarrjes për politikën e sistemit prokurorial, përfshirë edhe beneficionet tjera të të qenit anëtar i KPK-së paraqiste situatë të konfliktit të interesit. Kësisoj, znj. Sevdije Morina kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në atë kohë të konfliktit të interesit të përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës dhe Ligjin mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.<sup>25</sup>

Pikërisht përmes këtij mandati të kontestuar dhe të vazhduar përmes konfliktit të interesit, ish-anëtarja e KPK-së, tani Zëvendëskryeprokuroreja e Shtetit kishte votuar për zgjedhjen e Aleksandër Lumezit në pozitën e Kryeprokurores të Shtetit.

Më vonë, znj. Morina ishte shpërblyer nga Kryeprokurori Lumezi, me pozitën

---

<sup>25</sup> Shih raportin e publikuar nga IKD "Konflikti i interesit në Këshillin Prokurorial të Kosovës". Dhjetor 2017. (Shih linkun: <https://kiks.org/konflikti-i-interesit-ne-keshillin-prokurorial-te-kosoves/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

<sup>26</sup> Shih analizën e publikuar nga IKD "Paligjshmëria e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit

e Zëvendëskryeprokurores të Shtetit, të cilën pozitë e mban edhe më tutje.

#### **b) Idain Smajli**

Me mandat të kontestuar në KPK për një kohë, sikurse prokurorja Morina, kishte qëndruar edhe prokurori Idain Smajli. Smajli ishte zgjedhur anëtar i KPK-së me vendim të KPK-së, A.nr. 05/11, me 15 shkurt 2011, nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë Komonale. Pas kalimit në strukturën e re organizative të prokurorisë, KPK sipas propozimit të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit, gjatë muajit dhjetor të vitit 2012, kishte vendosur që Idain Smajlit t'ia vazhdojë mandatin e tij si anëtar i Këshillit, duke përfaqësuar Prokurorinë e Apelit.

Këtë veprim, KPK e kishte interpretuar si fillim i mandatit të ri nga 1 janari 2013. Lidhur me këtë, IKD kishte publikuar një raport ku kishte vlerësuar se në rastin e prokurorit Smajli kemi të bëjmë me vazhdimin e mandatit që kishte filluar me 15 shkurt 2011 dhe i cili ka mbaruar më 15 shkurt 2016. Por, prokurori Smajli kishte vazhduar të mbajë pozitën e anëtarit në KPK edhe pas kësaj date.<sup>26</sup>

#### **c) Lulzim Sylejmani**

Prokurori tjetër në ZKPSH është Lulzim Sylejmani. Z. Sylejmani nuk është për

Prokurorial". Nëntor 2016. (Shih linkun: <https://kiks.org/lajme/publikimeantikorrupsionimonitorim-kgj-kpkllogaridhenia-e-gjyqesoritdrejtesia-ne-zgjedhje-paligjshmeria-e-keshillit-gjyqesor-dhe-keshillit-prokurorial-te-kosoves/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

herë të parë në ZKPSH vartës i Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi. Paraprakisht, Sylejmani kishte qenë prokuror në Prokurorinë e Apelit kreu i së cilës prokurori kishte qenë pikërisht z. Aleksandër Lumezi.

Ndryshe, emri i Sylejmanit ishte bërë lajm në fund të vitit 2016, kur i njëjti kishte pësuar një aksident trafikës, dhe ishte dërguar për shërim jashtë vendit, konkretisht në Beograd.

## 7.6. Transferimet e tjera të kundërligjshme

Krahas rasteve të lartcekura, veprime të ngjashme kundërligjore, Kryeprokurori i Shtetit por edhe KPK ka një kohë që kanë instaluar.

Avancime pa kritere dhe pa konkurse në emër të transferimeve ishin bërë edhe në të kaluarën, përkatësisht në rastin e transferimit të prokurorëve Sylë Hoxha dhe Abdurrahim Islami të cilët me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, e më pas edhe të KPK-së, ishin ngritur nga prokuroritë themelore në PSRK.<sup>27</sup>

Njëjtë sikurse tash, IKD kishte reaguar edhe atë kohë për transferimet e paligjshme.<sup>28</sup>

<sup>27</sup> Shih raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. "Vendimet e kundërligjshme të KPK-së dhe praktikatat e këqija të ndryshimit të Rregulloreve nga KGJK". Dhjetor 2016 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/vendimet-e-kunderligjshme-te-kpk-se-dhe-praktikat-e-keqija-te-ndryshimit-te-rregulloreve-nga-kgjk/>) Qasur për herën e fundit, 8 shkurt 2021.

<sup>28</sup> Shih raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi "Vendimet e kundërligjshme

## 8. Integriteti i kontestuar i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Përkundër se në hierarkinë e sistemit prokurorial, Kryeprokurori i Shtetit mban pozitën më të lartë dhe si i tillë ka edhe përgjegjësinë për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorisë së Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, nëse nisemi nga parimi "udhëheq sipas shembullit", atëherë prokurorët e niveleve më të ulëta nuk është që kanë ndonjë arsye për të ndjekur shembullin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ky i fundit, nisur nga pozita që mban, do duhej të ishte shembull në respektimin e ligjit për të gjithë prokurorët dhe qytetarët, por praktika e ka dëshmuar krejt të kundërtën.

Që nga viti 2015 kur z. Lumezi është zgjedhur në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, ka pasur një varg skandalesh të cilat kanë cenuar integritetin e kësaj zyre.

Përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, prokurorët e ZKPSH-së pranojnë paga të majme, me qëllim që brenda ditës të punojnë tetë (8) orë dhe punën e tyre ta kryejnë me efikasitet, profesionalizëm dhe integritet. Por, përkundër kësaj, shumica e

të Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së për transferimin e prokurorëve në PSRK". Shkurt 2017. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/vendimet-e-kunderligjshme-te-kryeprokurorit-te-shtetit-dhe-keshillit-prokurorial-per-transferimin-e-prokurorëve-ne-prokurorine-speciale-te-republikes-te-kosoves/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

prokurorëve të ZKPSH-së krahas pagës së tyre pranojnë edhe të ardhura nga burime të tjera për angazhime të cilat i bëjnë krahas punës të tyre bazë si prokuror në ZKPSH. Madje, në një rast, përfitimet nga burimet e tjera, në kundërshtim me ligjin, shkojnë deri në 50% të pagës bazë.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik në nenin 13.2 të tij ndër të tjera ka përcaktuar se “Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, **nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë**, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”.

Organeve të cilat i referohet ky ligj, janë organet drejtuese të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike.

Por, në kundërshtim të plotë me këto dispozita ligjore, prokurorët e ZKPSH-së, kanë vazhduar të realizojnë në emër të shtesave, mijëra euro.

Në të paktën një (1) rast, IKD ka gjetur se një (1) prokuror i ZKPSH-së, me të ardhurat prej aktiviteteve tjera të lejuara krahas pagës bazë, ka tejkalluar edhe lartësinë prej 25% të pagës bazë siç është përcaktuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Ndërsa, të tjerë prokurorë të kësaj zyre, në

kundërshtim me ligjin në fjalë, kanë realizuar mijëra euro të ardhura në emër të shtesave gjatë vitit 2020.<sup>29</sup>

Lidhur me çështjen e kompensimeve dhe shtesave të tjera, ZKPSH në një përgjigje për IKD ka theksuar se prokurorët kanë të drejtë të ligjërojnë në institucione arsimore pas orarit të punës dhe për këtë kanë të drejtë në shpërblim vetëm deri në 25% të pagës vjetore bruto, ndërsa në përgjigje thuhet se sipas të dhënave që ka ZKPSH për këtë aktivitet nuk ka tejkallim të këtij pragu. Gjithashtu, ZKPSH në përgjigjen e saj thekson se është obligim i prokurorëve që të mbajnë trajnime në Akademinë e Drejtësisë.<sup>30</sup>

Mirëpo, sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, jo domosdoshmëritë prokurorët janë të obliguar të mbajnë trajnime në Akademi.

Neni 24 i Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë përcakton se “1.Trajnuesit në Akademi janë gjyqtarë, prokurorë, profesorë universitarë dhe profesionistë të tjerë. Trajnuesit janë të përkohshëm ose të përhershëm. 2.Mënyra e përzgjedhjes së trajnuesve të përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe të prokurorëve përcaktohet me rregullore të brendshme të KPK-së dhe KGJK-së, të cilët i propozohen për miratim Këshillit Drejtues të Akademisë, për periudhën një (1) vjeçare, me mundësi të vazhdimit më së shumti edhe dy herë. 3. Trajnuesit e

marrë nga deklarimi i pasurisë që prokurorët e kanë bërë në Agjencinë Kundër Korrupsion.

<sup>30</sup> Përgjigje nga ZKPSH për IKD. 12 shkurt 2021.

<sup>29</sup> **Shënim:** Të dhënat lidhur me pagat, kompensimet, mëditjet dhe shtesat tjera janë

përherëshëm të cilët nuk janë gjyqtarë dhe prokuror të shtetit themelojnë marrëdhënie pune në Akademi sipas rregullave të shërbimit civil”.

Pra, sipas ligjit në fjalë, si trajnues në Akademinë e Drejtësisë krahas gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të angazhohen edhe profesorët universitarë dhe profesionistët e tjerë.

Krahas faktit se jo domosdoshmërisht vetëm gjyqtarët dhe prokurorët mund të jenë ligjërues në Akademinë e Drejtësisë, duhet përmendur edhe faktin se sipas ligjit, jo vetëm një numër i caktuar i prokurorëve mund të jenë trajnues, por, kjo mundësi është e hapur për të gjithë prokurorët.

Për më tepër, në kontekst të këtij trajtimi, duhet të theksohet fakti se pikërisht Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi ka qenë deri në vitin 2020, kryetar i Bordit të Drejtues të Akademisë, pikërisht nga i cili bord janë zgjedhur për trajnues vartësit e tij.

Gjithashtu, ZKPSH thekson në përgjigjen për IKD se angazhimet që bëhen me vendime të qeverisë, institucioneve të Kosovës, apo vet KPK-së, apo kur parashihen me ligj janë obligative dhe po ashtu janë jashtë kufizimeve të parapara në nenin 25.

Në përgjigjen e ZKPSH-së për këtë raport thuhet se ky institucion përkrah plotësisht heqjen e shpërblimeve për sa kohë që ushtrohet veprimtaria e detyrës së prokurorit.

Një gjë e tillë, nuk është fare kontestuese as për IKD-në. Porse, siç është trajtuar edhe në këtë raport, për angazhime të kësaj natyre, prokurorët nuk kanë të drejtë të pranojnë shpërblim me pagesë, përjashtimisht shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të. Në këtë drejtim, siç do të shihet më poshtë, prokurorët e ZKPSH-së kanë pranuar të ardhura të majme pikërisht nga këto angazhime. Lidhur me qëndrimin e ZKPSH-së se e përkrah ndryshimin e ligjit që mohon përfitimet, IKD thekson se ky ligj tanimë është në fuqi, e që është Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Për më tepër, minimalisht, nëse ekziston ky vullnet që theksohet në përgjigjen e ZKPSH-së, atëherë prokurorët kanë mundur t'i refuzojnë shpërblimet e tilla.

*i) Aleksandër Lumezi*

Që nga zgjedhja e z. Aleksandër Lumezi në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, integriteti i tij dhe rrjedhimisht i ZKPSH-së është cenuar vazhdimisht, nga skandalet sikurse ai për “*Dosjen e manipuluar të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi*”<sup>31</sup>, afera “*Pronto*”<sup>32</sup>, afera e “*Veteranëve të rrejshëm*”<sup>33</sup>, vendimet e kundërligjshme për transferim të prokurorëve e deri tek mos zbatimi i masave anti-Covid-19.<sup>34</sup>

Gjithashtu, z. Lumezi vazhdon të jetë një prej “**supermeneve**” të institucioneve publike në Kosovë, praktikë kjo që ishte adresuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.<sup>35</sup>

Sipas deklaramentit të pasurisë që z. Lumezi ka bërë në vitin 2020, del se i njëjti përveç pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, gjatë vitit të kaluar ka mbajtur edhe dy (2) pozita drejtuese, përkatësisht pozitën e Kryetarit të Bordit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë deri në shtator 2020 dhe

<sup>31</sup> Shih analizën e publikuar nga IKD “*IKD publikon analizën ligjore: Dosja e manipuluar e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi*”. Nëntor 2017 (Shih linkun: <https://kliks.org/ikd-publikon-analizen-ligjore-dosja-e-manipuluar-e-kryeprokurorit-te-shtetit-aleksander-lumezi/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021).

<sup>32</sup> Shih raportin e publikuar nga IKD “*Pronto, kah je?*”. Dhjetor 2017. (Shih linkun: <https://kliks.org/pronto-kah-je/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

<sup>33</sup> Shih raportin e publikuar nga IKD “*Ndërrhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata*”. Gusht 2018. (Shih linkun: <https://kliks.org/nderhyrjet-politike-ne-sistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>)

pozitën e Kryetarit të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës deri në mars 2020. Po ashtu, i njëjti sipas detyrës zyrtare vazhdon të mbajë ende pozitat e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, anëtarit të bordit në Akademinë Policore të Kosovës, anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe anëtar i Bordit të Inteligjencës Financiare.

Sipas nenit 13 (2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, “*zyrtarit të lartë i ndalohet të jetë drejtues i më shumë se një organi drejtues të një institucioni publik përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj*”. Kryeprokurori i Shtetit në asnjërin prej dy pozitave të tjera drejtuese, nuk i përcaktohej me ligj se duhet të jetë drejtues i institucionit. Prandaj, ushtrimi i këtyre pozitave drejtuese konsumonte veprën penale të konfliktit të interesit, gjë që do duhej të ndiqej pikërisht nga Prokurori i Shtetit.

Për këto pozita të cilat i mban, z. Lumezi, ai ka deklaruar të ardhura

[sistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/](#) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

<sup>34</sup> “*Kryeprokurori Lumezi nuk respekton vendimin e Qeverisë për vendosjen e maskës*”. Koha.net. 20 korrik 2020 (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/230203/kryeprokurori-lumezi-nuk-respekton-vendimin-e-qeverise-per-vendosjen-e-maskes/>) Qasur për herën e fundit më 8 shkurt 2021.

<sup>35</sup> Ligj ??, Neni 13.2. “*zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj*”.

vjetore shumë prej 41,285.00 euro, paçka se në deklarin e tij të pasurisë nuk i ka ndarë të ardhurat veç e veç për secilën pozitë, ashtu siç kërkohet me ligj.<sup>36</sup> Krahas këtyre të ardhurave, Lumezi ka deklaruar edhe 1,404 euro nga mëditjet, ushqimi, akomodim dhe udhëtime zyrtare. Si total, Lumezi ka deklaruar 42,689.00 euro.

Nëse nga kjo shumë e deklaruar nga z. Lumezi, e heqim shumë prej 35,400.00 euro, aq sa është paga vjetore e kryeprokurorit të shtetit, atëherë i bie se kryeprokurori në emër të shtesave kishte realizuar shumë prej 7,289.00 euro.

### *ii) Sevdije Morina*

Gjatë vitit 2020, të ardhura vjetore nga KPK, zëvendëskryeprokurorja e ZKPSH-së, Sevdije Morina i ka deklaruar 31,652.54 euro, kurse, 5,430.00 euro të ardhura, znj. Morina i ka deklaruar nga puna e saj si trajnuese në Akademinë e Drejtësisë si dhe nga CILC Hagë Holandë, GIZ, UNDP dhe shpenzime të udhëtimit nga KPK.

Nisur nga kjo, si të ardhura nga aktivitete tjera të lejuara përveç pozitës së saj si prokurore, znj. Morina i ka deklaruar 4,295.00 euro, ndërsa në emër të shtesave tjera, prokurorja Morina i ka deklaruar 1,135.44 euro.

### *iii) Besim Kelmendi*

Prokurori tjetër i ZKPSH-së, Besim Kelmendi, ka deklaruar se përveç pozitës së prokurorit mban edhe pozitën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për parandalimin e dhunës, sjelljeve të palejuara, dukurive negative dhe kurdisjeve në ngjarjet sportive si dhe është ligjërues/trajnues në Akademinë e Drejtësisë, Kolegjin "Biznesi" dhe Kolegjin Evropian të Kosovës. Për këto pozita, Kelmendi ka deklaruar se merr pagë vjetore nga Prokurori i Shtetit në lartësi prej 32,550.61 euro, kurse si pagë sekondare dhe kompensime e mëditja tjera, 21,593.00 euro.

Në total, Kelmendi ka deklaruar të ardhura në shumë prej 54,143.00 euro, më shumë se secili prokuror tjetër.

Në këtë rast, Ligji i Prokurorit të Shtetit ka përcaktuar se prokurorët me aprovim paraprak të Kryeprokurorit të Prokurorisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve. Por, në paragrafin 4 të nenit 25, është përcaktuar se për aktivitetet e parapara në këtë nen, prokurorët pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej **njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë.**<sup>37</sup>

<sup>36</sup> Ligj për Nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Neni 5.3.

<sup>37</sup> Ligji nr.06/L-025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034. Neni 25.

Në rastin e prokurorit Kelmendi, ky i fundit në deklarin e tij të pasurisë ka deklaruar të ardhura vjetore nga paga në lartësi prej 32,550.61 euro, kurse, të ardhurat tjera që i ka deklaruar përbëjnë 66% të pagës bazë.

Nëse nga kjo heqim shumën prej 5,195.00 euro që prokurori Kelmendi i ka realizuar si shtesa, atëherë, mbetet shuma prej 16,398.00 euro që z. Kelmendi i ka realizuar nga aktivitete tjera të lejuara krahas punës së tij si prokuror. Kjo shumë paraqet 50% të pagës së tij bazë.

Vetëm nga të ardhurat e tij si ekspert i angazhuar nga UNDP dhe OSBE, prokurori Besim Kelmendi pothuajse arrin limitin prej 25% të pagës bazë.

Me këtë rast, është e çuditshme se si këta mekanizma ndërkombëtarë futen në praktika të kësaj natyre, kur dihet fakti se të njëjtit kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar në shumicën e ligjeve me interes për fushën e sistemit të drejtësisë dhe parandalimit të konfliktit të interesit.

Me këtë mënyrë të veprimit, del se prokurori Kelmendi ka vepruar në kundërshtim me ligjin i cili e ka përcaktuar shumën prej 25% të pagës bazë si "tavan" që prokurorët mund të pranojnë shpërblime për aktivitete tjera profesionale jashtë punës së tyre si prokurorë.

Po ashtu, e njëjta situatë paraqitet edhe në vitin 2019. Sipas deklarinimit të pasurisë të z. Kelmendi, i njëjti kishte deklaruar si pagë bazë shumën prej

31,942.53 euro, kurse për angazhime në aktivitete të tjera të lejuara me ligj, Kelmendi kishte deklaruar paga të ardhura në shumën prej 8,922.00 euro, që paraqet 27.9% të pagës bazë, pra sërish kishte pasur tejkalim të vlerës prej 25% të pagës bazë.

#### *iv) Laura Pula*

Prokurorja Laura Pula, në deklarin e saj të pasurisë ka treguar se përveç pozitës së prokurores është edhe trajnuese/ligjëruese në Akademinë e Drejtësisë dhe në Kolegjin "AAB". Paga dhe pagesa për komisione, znj. Pula ka deklaruar 38,431.64 ndërsa si mëditje, znj. Pula kishte deklaruar 972 euro. Të hyra nga puna si trajnuese/ligjëruese, Pula ka deklaruar 2,753.00 euro. Si total, del se znj. Pula kishte realizuar të ardhura në lartësi prej 42,156.00 euro.

Vetëm nga KPK, në emër të pagës, pagesave për komisione dhe mëditje, znj. Pula i kishte deklaruar 39,403.00 euro.

Nëse llogaritim pagën bazë vjetore të prokurorëve në ZKPSH që është 31,860.00 euro, atëherë, del se znj. Pula kishte realizuar shtesa në shumën prej 7,543.00 euro.

Ndërsa shuma prej 2,753.00 euro që znj. Pula i ka realizuar nga aktivitete tjera të lejuara krahas punës së saj si prokurore, nuk e kalon përqindjen prej 25% të përcaktuar me ligj.

#### *v) Bahri Hyseni*

Ish-kryesuesi i KPK-së, tash prokuror i transferuar në ZKPSH, Bahri Hyseni ka deklaruar pagë bazë në shumë prej

33,268.89 euro, kurse të ardhura tjera nga mëditjet në KPK i kishte deklaruar 967 euro.

Kurse, nga puna si trajnues në Akademinë e Drejtësisë, Kolegjin "Juridica", si dhe pagesa për shpenzime të tjera ku nuk janë specifikuar burimi i saktë, z. Hyseni ka deklaruar shumën prej 2,993.00 euro.

#### *vi) Shqipdon Fazliu*

Prokurori Shqipdon Fazliu në deklarimin e pasurisë së tij në vitin 2020 ka raportuar të ardhura nga paga, mëditjet dhe shtesat nga KPK shumën prej 42,173.00 euro. Me këtë rast, prokurori Fazliu si burim të vetëm të ardhura ka deklaruar KPK-në. Por, z. Fazliu në deklarimin e tij të pasurisë nuk i kishte ndarë të ardhurat nga paga e tij me shtesat dhe mëditjet tjera, ashtu siç kërkohet me ligj.

Kësisoj, nëse nga shuma totale e të ardhurave të deklaruara nga z. Fazliu, heqim pagën bazë bruto vjetore, që sipas ligjit, për prokurorët në ZKPSH është 31,860 euro, atëherë, i bie se 10,313 euro, të tjera, prokurori Fazliu i ka realizuar në emër të mëditjeve dhe të shtesave.

#### *vii) Agron Qalaj*

Prokurori Agron Qalaj ka raportuar se është i angazhuar edhe si trajnues në Akademinë e Drejtësisë dhe në organizatën National Institution Trial Advocacy, ndërsa pagë vjetore ka deklaruar 29,822.00 euro kurse të ardhura nga mëditjet, avanset për ushqime dhe shpenzime të udhëtimit,

shumën prej 2,620.00 euro. Si të ardhura nga Akademia e Drejtësisë, prokurori Qalaj ka deklaruar të ardhura në lartësi prej 384 euro.

#### *viii) Lulzim Sylejmani*

Një prokuror tjetër në ZKPSH, Lulzim Sylejmani, në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte deklaruar 34,007.00 euro të ardhura. Në këtë shumë, prokurori Sylejmani ka përfshirë edhe kompensimet shtesë të punës dhe mëditjet, pa i ndarë këto të ardhura veç e veç.

Po ashtu, Sylejmani kishte bërë të ditur se ka pranuar edhe 267 euro mëditje nga ZKPSH.

Në total, Sylejmani ka deklaruar të ardhura prej 34,274.00 euro.

#### *ix) Idain Smajli*

Kurse, prokurori Idain Smajli në deklarimin e tij të pasurisë ka deklaruar pagën mujore prej 2,634 euro, që brenda vitit i bie se ka marrë 31,608 euro.

Ndërsa, të ardhura nga mëditjet nga KPK, prokurori Smajli ka deklaruar 269 euro.

# PAGAT DHE KOMPENSIMET E PROKURORËVE NË ZKPSH

Prokurorët	Paga bazë sipas ligjit	Paga e deklaruar	Shtesat e deklaruar	Veprimtaritë profesionale	Totali vjetor i të hyrave	Deklarimi sipas ligjit
 Besim KELMENDI	31,860 €	32,550 €	5,195 €	16,398 €	54,143 €	✓
 Aleksandër LUMEZI	35,400 <sup>1</sup> €	41,285 €	1,404 €	0 €	42,689 €	X
 Shqipdon FAZLIU	31,860 <sup>2</sup> €	42,173 €	0 €	0 €	42,173 €	X
 Laura PULA	31,860 <sup>3</sup> €	38,431 €	972 €	2,753 €	42,156 €	X
 Bahri HYSENI	35,400 €	33,268 €	967 €	2,993 €	37,228 €	✓
 Sevdije MORINA	31,860 €	31,652 €	1,135 €	4,295 €	37,082 €	✓
 Lulzim SYLEJMANI	31,860 <sup>4</sup> €	34,007 €	267 €	0 €	34,274 €	X
 Agron QALAJ	31,860 €	29,822 €	2,620 €	384 €	32,826 €	✓
 Idain SMAJLI	31,860 €	31,608 €	0 €	269 €	31,877 €	✓

SHUMICA E PROKURORËVE NUK E KANË DEKLARUAR PAGËN BAZË DHE TË HYRAT E TJERA SIPAS OBLIGIMIT LIGJOR.

"Prokurorët dhe Kryeprokurorët, për aktivitetet e parapara, në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) përqind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin, kurse Kryeprokurorët e njoftojnë Këshillin."

"Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të."

LIGJI I PROKURORIT TË SHTETIT

LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

1 Prokurori Lumezi në deklarimin e tij tek pagat i ka përfshirë edhe të ardhurat nga bordet dhe komisioni për provimin e jurisprudencës duke mos i ndarë ato veç e veç.

2 Prokurori Fazliu në deklarimin e tij, tek pagat ka përfshirë edhe të ardhurat nga mëditjet dhe shtesat, duke mos i ndarë ato veç e veç.

3 Prokurorja Pula, në deklarimin e saj tek pagat i ka përfshirë edhe të ardhurat nga komisionet duke mos i ndarë të ardhurat veç e veç.

4 Prokurori Sylejmani, në deklarimin e tij tek pagat i ka përfshirë edhe të ardhurat nga kompensimet shtesë të punës dhe mëditjet, duke mos i ndarë ato veç e veç.

## 9. Rekomandime

- ❖ Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të inicioj hetim penal kundër Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi dhe prokurorit z. Bahri Hyseni për konflikt të interesit me rastin e avancimit të këtij të fundit në ZKPSH;
- ❖ KPK mos të vazhdojë transferimin e kundërligjshëm të prokurorit Bahri Hyseni në ZKPSH;
- ❖ ZKPSH të ndalojë praktikën e kundërligjshme të avancimeve në emër të transferimeve;
- ❖ Këshilli Prokurorial i Kosovës të merr vendime bazuar në ligj dhe në aktet e brendshme të KPK-së në rastet e avancimeve dhe transferimet e prokurorëve;
- ❖ Prokurorët të shmangin konfliktet e interesit;
- ❖ Prokurorët të veprojnë konform Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe të mos pranojnë shpërblime për aktivitetet profesionale që kalojnë shumë prej 25% të pagës bazë;
- ❖ Për të gjitha konfliktet e interesit të paraqitura në veprimtarinë e ZKPSH-së të reagojë Agjencia Kundër Korrupsion;
- ❖ Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të nxjerrë udhëzime të ligjshme me shkrim, në mënyrë që të ngrisë kualitetin në fushën e ndjekjes penale dhe zbatimin unik të ligjeve.